

KËRKESË
Nr. 3656/1, datë 6.4.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës Tip 2 + Tip 4 në Njësinë Administrative nr. 11, Sheshi 11/1”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për pronarët sipas listës emërore më poshtë. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), me adresë: “Rruga e Durrësit”, nr. 23, Tiranë.

LISTA E PASURIVE PRIVATE
ZËRI KADASTRAL AKTIVITET PRIVAT, SHTËPI BANIMI ETJ., QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 2 + TIP 4 NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NR. 11, SHESHI 11/1”, TIRANË

Nr.	Z K	Nr. i pasurisë	Adr:	Pronari	Sipërf. truall	Sipërf. ndërt.	Çmimi i truallit lekë/m ²	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtësë	Shënime
1	8320	1/621		Diana Aleksandër Hoxha, Robert Aleksandër Dako, Viktoria Aleksandër Ruli	8.963	0	22,985	0	206,014,556	0	206,014,556	